



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
AGJENCIA E SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK

Lënda: LISTA E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO-LIGJOR QË DUHET DORËZUAR PËR KËRKESAT PËR MIRATIM PROJEKTI ZHVILLIMOR PËR RRUGË (RRJETE) ME SHTRIRJE TË MADHE (LLOJI I ZHVILLIMIT KOMPLEKS)

Kjo listë ka vetëm vlerë orientuese, në çdo rast ASHA do të vlerësojë aplikimin dhe do të përcaktojë rast pas rasti në varësi të projektit që do të zhvillohet dhe zonën përkatëse, dokumentacionin e nevojshëm sipas legjislacionit në fuqi.

- 1. Kërkesë për miratim projekti** e firmosur nga investitori, ose përfaqësuesi i tij i autorizuar ose me prokurë. Nëse kërkesa është firmosur nga përfaqësues me prokurë, kjo e fundit të jetë hartuar para noterit dhe të depozitohet në formën e kërkuar nga ligji.(origjinale ose e noteruar)
- 2. Paga e tarifës së aplikimit** miratuar me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015.
- 3. Projekti teknik ndërtimor i rrugës (rrjetit)**, firmosur nga projektuesi i licencuar, shoqëruar me CD e këtij projekti dhe PowerPoint i tij. Projekti përmban:
 - **Planvendosjen e rrugës dhe objekteve të saj (rrjetit dhe objekteve të tij)**, planet për segmente të ndryshme rrugore (të rrjetit), profilet gjatësorë ose tërthorë, detaje të ndërtimi që tregojnë thellësinë e gërmimeve. (sipas llojit të punimeve).
- 4. Raporti i Vëzhgimit Arkeologjik*** i zonës ku kërkohet ndërhyrje, i cili mund të kryhet nga individ apo shoqëri të licencuar në arkeologji, ose Institucione Shtetërore të Specializuara.
 - **Raporti i vëzhgimit arkeologjik**, CD me prezantimin në Power-Point të raportit.

* Dokumentacioni sqarues për mënyrën e paraqitjes dhe hedhjes në sistem të Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik, ndodhen në faqen www.asha.gov.al / Aplikime / Procese Arkeologjike

- **Standarti i miratuar i vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor**
- **Lista për ngarkimin e materialeve – Vëzhgim Arkeologjik**